



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
MINISTRIA E FINANCEVE

## RAPORT FINANCIAR PARAZGJEDHOR

Shkup, 20.08.2021

Kodi Zgjedhor (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr.40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 31/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.98/19 dhe 42/20) në nenin 8-a paragrafi (4) përcakton obligim për Ministrinë e Financave dy javë pas shpalljes së zgjedhjeve që të parashtrijë Raport financiar parazgjedhor, në të cilin do të përfshihet pasqyrë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara nga Buxheti sipas zërave, në periudhën nga fillimi i vitit fiskal deri në ditën e parashtrimit të raportit.

Në pajtim me Buxhetin e RMV-së për vitin 2021, të ardhurat e përgjithshme janë planifikuar në nivel prej 222.542 miliardë denarë, ndërsa niveli i planifikuar i shpenzimeve të përgjithshme është 268.772 miliardë denarë.

Në periudhën nga fillimi i vitit fiskal deri në datë 20 gusht të vitit 2021, të ardhurat e përgjithshme të realizuara në Buxhetin e RMV-së janë **133.5 miliardë denarë**.

Në suazat e të ardhurave të përgjithshme në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 121.4 miliardë denarë janë realizuar në bazë të të ardhurave tatimore dhe kontributeve sociale, përkatësisht 90.1% nga të ardhurat e përgjithshme. Të ardhurat jotatimore janë realizuar në vlerë prej 8.6 miliardë denarë ose të njëjtat janë 6.4% nga të ardhurat e përgjithshme. Të ardhurat kapitale janë realizuar në vlerë prej 631 milionë denarë apo 0.5%, ndërsa transferet dhe donacionet janë 2.8 miliardë denarë apo kanë pjesëmarrje me 2.1% nga të ardhurat e përgjithshme.

Në strukturën e të ardhurave tatimore pjesëmarrjen më të madhe e kanë të ardhurat e arkëtuara nga tatimet në vend për mallra dhe shërbime që janë realizuar në vlerë prej 51.9 miliardë denarë. Në suazat e njëjta, në bazë të TVSH-së janë realizuar 34.9 miliardë denarë, në bazë të akcizës 16 miliardë denarë, ndërsa në bazë të tatimit për automjete motorike 1 miliardë denarë. Kontributet për sigurim social, si të ardhura burimore të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor, të Agjencisë për punësim të RMV-së dhe të Fondit për sigurim shëndetësor, janë realizuar në vlerë prej 44.7 miliardë denarë. Tatimet mbi të ardhurat, tatimi mbi fitim dhe tatimet mbi fitimet kapitale janë 20

miliardë denarë, tatimi nga tregtia ndërkombëtare dhe transakcione (dogana) është realizuar në vlerë prej 4.1 miliardë denarë, ndërsa nga të ardhurat tjera tatimore (Taksa për shfrytëzim ose leje për kryerje të veprimtarisë) në këtë periudhë të vitit janë arkëtuar 746 milionë denarë.

Të ardhurat jotatimore në Buxhetin e RMV-së me përfundim në datë 20 gusht të vitit 2021 janë realizuar në vlerë prej 8.6 miliardë denarë, në të cilat të ardhurat nga taksat dhe kompensimet janë realizuar në vlerë prej 1.5 miliardë denarë (në pjesën më të madhe taksa në arsim të lartë në vlerë prej 1.1 miliardë denarë). Në kuadër të të ardhurave jotatimore janë realizuar të ardhura nga taksat gjyqësore dhe administrative në vlerë prej 793 milionë denarë dhe të ardhura nga gjobat në vlerë prej 529 milionë denarë.

Në bazë të të ardhurave nga shërbimet tjera qeveritare (të ardhura nga lëshimi i dokumenteve personale, kompensime për leje dhe licenca, kompensime nga lojëra të fatit dhe tjera) është realizuar vlerë prej 3.1 miliardë denarë, të ardhurat e tjera jotatimore janë realizuar në vlerë prej 2.6 miliardë denarë, ndërsa të ardhura nga prona (interesi i depozitave dhe të tjera) në vlerë prej 40 milionë denarë.

Të ardhurat kapitale në periudhën e analizuar janë realizuar në vlerë prej 631 milionë denarë (shitje e mjeteve kapitale në vlerë prej 100 milionë denarë, shitje e tokës dhe investime jomateriale në vlerë prej 469 milionë denarë dhe të ardhura nga dividenda në vlerë prej 61 milionë denarë). Donacionet dhe transferet në periudhën e analizuar janë realizuar në vlerë prej 2.8 miliardë denarë, nga të cilat 2.6 miliardë denarë janë donacione prej jashtë.

Në periudhën janar – 20 gusht 2020, shpenzimet e përgjithshme të realizuara në Buxhetin e RMV-së janë në nivel prej 158.3 miliardë denarë.

Pagat dhe kompensimet janë realizuar në vlerë prej 20.5 miliardë denarë. Për blerje të mallrave dhe shërbimeve në periudhën e analizuar janë realizuar gjithsej 30.4 miliardë

denarë. Pjesëmarrje më të madhe në mallrat dhe shërbimet e përgjithshme kanë shërbimet kontraktuese në vlerë prej 23.4 miliardë denarë. Në suaza të shërbimeve kontraktuese 19.8 miliardë denarë janë paguar për mbrojtje shëndetësore të popullatës. Këto mjete janë realizuar përmes Fondit për sigurim shëndetësor për shërbime të kryera si nga institucionet publike shëndetësore ashtu edhe nga institucionet private që janë pjesë e rrjetit shëndetësor.

Në suaza të shpenzimeve të përgjithshme për mallra dhe shërbime janë realizuar edhe shpenzime për shërbime komunale në vlerë prej 1.8 miliardë denarë, shpenzime për materiale dhe inventar të imët në vlerë prej 3.4 miliardë denarë (përmes Ministrisë së shëndetësisë për ilaçe dhe vaksina janë shpenzuar 2.2 miliardë denarë), për riparime dhe mirëmbajtje rrjedhëse në vlerë prej 803 milionë denarë, për shpenzime tjera rrjedhëse (provizione, anëtarësi dhe ngjashëm) në vlerë prej 635 milionë denarë, shpenzime ditore dhe të rrugës 284 milionë denarë dhe punësime të përkohshme në vlerë prej 97 milionë denarë.

Në pajtim me Ligjin për financim të njërive të vetëqeverisjes lokale nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes kategorisë transfere rrjedhëse për njësitë e vetëqeverisjes lokale realizohen bllok dotacione dhe dotacione të dedikuara dhe dotacioni nga TVSH-ja në bazë mujore. Në këtë periudhë janë realizuar 14 miliardë denarë edhe atë në bazë të dotacioneve nga TVSH-ja janë realizuar 1.3 miliardë denarë, ndërsa për bllok dotacionet dhe dotacionet të dedikuara janë realizuar 12.7 miliardë denarë.

Në pajtim me planet për amortizim në këtë periudhë të vitit të maturuara dhe të paguara janë 7.5 miliardë denarë për pagesa të interesit në bazë të kredive të shfrytëzuara dhe letrave shtetërore me vlerë të emetuara. Në këtë pjesë pagesat e interesit për kreditorët jorezidentë janë kryer në vlerë prej 5.7 miliardë denarë, kurse për pagesa të interesit për kreditorët rezidentë janë paguar 1.8 miliardë denarë.

Subvencionet dhe transferet janë realizuar në vlerë të përgjithshme prej 16.7 miliardë denarë. Në këtë kategori pjesëmarrjen më të madhe e kanë subvencionet në bujqësi, të paguara nga Agjencia për përkrahje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural në

vlerë prej 5.7 miliardë denarë, masat e Qeverisë për ballafaqim me pandeminë COVID-19 në vlerë prej 3 miliardë denarë, Drejtoria e të Ardhurave Publike në vlerë prej 1.1 miliardë denarë për TVSH-jaIme, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës janë realizuar shpenzime për konviktet e nxënësve dhe ato studentore, bursa dhe pagesa të shkollimit në vend dhe jashtë vendit në vlerë prej 600 milionë denarë.

Beneficionet sociale nga fillimi i vitit deri në datë 20.08.2021 janë paguar në vlerë prej 59.4 miliardë denarë. Në këto suaza mjetet më të konsiderueshme janë realizuar përmes Fondit për sigurim pensional dhe invalidor edhe atë 41.3 miliardë denarë janë dedikuar për pagesë të tetë pensioneve mujore për 325.081 pensionistë, ndërsa për shpenzime tranzicioni për fondet private të pensionimit janë realizuar 6.4 miliardë denarë. Shpenzimet për ndihmë sociale janë realizuar në vlerë prej 7.9 miliardë denarë. Për realizimin e të drejtës për kompensim financiar në rast të papunësisë, masa aktive për punësim dhe punësim të personave me invaliditet nëpërmjet Agjencisë për punësim në RMV janë realizuar 1.4 miliardë denarë, ndërsa për shpenzimet për pushim mjekësor dhe pushim të lehonisë përmes Fondit për sigurim shëndetësor janë realizuar 2.4 miliardë denarë.

Shpenzimet kapitale të Buxhetit të RMV-së me përfundim në datë 20 gusht janë realizuar në vlerë prej 9.9 miliardë denarë. Për blerje të pajisjeve dhe makinerive janë paguar 950 milionë denarë, derisa për objekte ndërtimore janë realizuar 3.4 miliardë denarë. Për subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare janë realizuar 1.5 miliardë denarë, derisa dotacione kapitale për NJVL-të janë paguar 176 milionë denarë.

Tabelë për të ardhurat dhe shpenzimet në Buxhetin e RMV-së për periudhën 01.01-20.08.2021

PËRSHKRIMI	Buxheti i RMV-së 2021	Realizimi 01.01- 20.08.2021
<b>Të ardhura të përgjithshme në Buxhetin e RMV-së</b>	<b>222,542,412,042</b>	<b>133,530,474,623</b>
<b>71 TË ARDHURA TATIMORE</b>	<b>193,067,811,000</b>	<b>121,445,456,567</b>
711 Tatimi mbi të ardhurat, mbi fitimin dhe fitimet kapitale	33,048,500,000	19,975,884,742
712 Kontribute për sigurim social	69,194,920,000	44,723,227,016
714 Tatime vendase për mallra dhe shërbime	82,730,661,000	51,899,672,005
715 transaksionet (dogana dhe detyrime)	6,468,000,000	4,100,747,468
716 Taksa të njëhershme të posaçme	0	11,061,998
717 Tatime për shërbime specifike	0	4,019,829
718 Taksa për shfrytëzim ose leje për kryerje të veprimtarisë	1,625,730,000	730,843,509
<b>72 TË ARDHURA JOTATIMORE</b>	<b>17,586,368,000</b>	<b>8,613,519,928</b>
721 Të ardhura sipërmarrësie dhe të ardhura nga pronat	255,150,000	39,880,967
722 Gjoha, taksa gjyqësore dhe administrative	2,044,462,000	1,322,388,028
723 Taksa dhe kompensime	3,656,102,000	1,503,749,366
724 Shërbime tjera qeveritare	5,293,161,000	3,135,259,176
725 Të ardhura tjera jotatimore	6,337,493,000	2,612,242,391
<b>73 TË ARDHURA KAPITALE</b>	<b>3,187,355,000</b>	<b>630,533,448</b>
731 Shitje të mjeteve kapitale	454,000,000	100,044,648
733 Shitje të tokës dhe investime jomateriale	1,223,350,000	469,322,903
734 Të ardhura tjera nga dividendat	1,510,005,000	61,165,897
<b>74 TRANSFERE DHE DONACIONE</b>	<b>8,700,878,042</b>	<b>2,840,964,680</b>
741 Transfere nga nivele tjera të pushtetit	61,680,000	187,490,421
742 Donacione nga jashtë	8,407,573,042	2,609,580,752
744 Donacione rrjedhëse	231,625,000	43,893,507

Shpenzime të përgjithshme në Buxhetin e RMV-së	268,771,681,042	158,316,681,100
<b>40 Paga dhe kompensime</b>	<b>31,596,826,000</b>	<b>20,498,844,276</b>
401 Paga themelore	22,157,359,000	14,362,351,362
402 Kontribute për sigurim social	9,179,477,000	6,001,805,500
404 Kompensime	259,990,000	134,687,414
<b>41 Rezerva dhe shpenzime të papërcaktuara</b>	<b>200,000,000</b>	<b>3,099,943</b>
412 Rezerva e përhershme (shpenzime të paparashikueshme)	100,000,000	499,943
413 Rezerva rrjedhëse (shpenzime të ndryshme)	100,000,000	2,600,000
<b>42 Shërbime dhe mallra</b>	<b>52,909,319,172</b>	<b>30,403,233,288</b>
420 Shpenzime ditore dhe të rrugës	793,673,000	283,897,961
421 Shërbime komunale, ngrohje, komunikacion dhe transport	3,199,838,300	1,803,807,263
423 Materiale dhe inventar i imët	6,147,789,000	3,417,297,606
424 Riparime dhe mirëmbajtje e vazdueshme	1,913,472,000	802,670,049
425 Shërbime kontraktuese	38,775,356,942	23,363,488,527
426 Shpenzime tjera rrjedhëse	1,811,216,930	635,269,560
427 Punësime të përkohshme	267,973,000	96,802,322
<b>44 Transfere rrjedhëse për njësitë e vetëqeverisjes lokale</b>	<b>21,329,031,000</b>	<b>13,963,318,570</b>
441 Dotacione nga TVSH-ja	2,238,000,000	1,305,500,000
442 Dotacione të dedikuara	406,700,000	268,802,998
443 Bllok dotacione	18,684,331,000	12,389,015,572
<b>45 Pagesë e interesit</b>	<b>9,378,100,000</b>	<b>7,545,535,601</b>
451 Pagesë e interesit ndaj kreditorëve jorezidentë	6,429,100,000	5,753,237,668
452 Pagesë e interesit ndaj kreditorëve vendas	2,949,000,000	1,792,297,933
<b>46 Subvencione dhe transfere</b>	<b>32,109,265,270</b>	<b>16,666,967,714</b>
461 Subvencione për ndërmarrje publike	1,530,000,000	849,475,524
462 Subvencione për ndërmarrje private	119,700,000	85,443,222
463 Transfere për organizatat joqeveritare	717,330,000	496,717,682
464 Transfere të ndryshme	29,160,100,425	14,415,398,407
465 Pagesë sipas dokumenteve të përmbarimit	582,134,845	819,932,879
<b>47 Beneficione sociale</b>	<b>91,446,299,000</b>	<b>59,372,204,066</b>
471 Kompensime sociale	12,311,299,000	7,910,268,839
472 Pagesë të beneficioneve nga Fondi për SPIM	72,017,000,000	47,656,386,608
473 Pagesë të kompensimeve nga Agjencia për punësim	3,318,000,000	1,376,080,453
474 Pagesë e kompensimeve nga Fondi për sigurim shëndetësor	3,800,000,000	2,429,468,166
<b>48 Shpenzime kapitale</b>	<b>29,802,840,600</b>	<b>9,863,477,642</b>
480 Blerje të pajisjeve dhe makinerive	6,691,860,600	949,613,485
481 Objekte ndërtimore	1,503,846,000	496,031,945
482 Objekte tjera ndërtimore	8,743,027,000	2,920,430,224
483 Blerje të mobiljeve	233,246,000	49,867,745
484 Mallra strategjike dhe rezerva tjera	717,365,000	104,952,349
485 Investime dhe mjete jofinanciare	7,619,325,000	3,664,363,867
486 Blerje e automjeteve	144,959,000	27,483,216
488 Dotacione kapitale për NJVL	1,226,850,000	176,188,930
489 Subvencione kapitale për ndërmarrje dhe organizata joqeveritare	2,922,362,000	1,474,545,881